



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit lidhur me ndikimin e pretenduar ndaj dëshmitarëve, Gjykatësi i Vetëm miratoi kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit të datës 30 prill, me të cilën kërkoj pranimin e 96 provave.

Këto prova përfshijnë të dhëna publike nga gjykimi i z. Thaçi për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, dëshmi publike të mëparshme të paraqitura prej dëshmitarëve të përmendur në Aktakuzë, artikuj nga mediat, versione të mëparshme të transkripteve dhe përkthimeve të audioincizimeve të vizitave të z. Thaçi në objektin e paraburgimit, aktekspertiza dhe materiale të tjera. Në vendim nuk u trajtuan dy aktekspertiza dhe pesë materiale të tjera. Gjykatësi informoi se aktekspertizat do të trajtohen në një vendim tjetër. Ai e vlerësoi kërkesën e Mbrojtjes si të tejkaluar lidhur me pesë materialet, sepse për to ishte bërë tashmë konstatimi gjyqësor. Gjykatësi i Vetëm pranoi si prova të gjithë materialet e mbetura pasi konstatoi se ishin *prima facie* autentike dhe relevante.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Mbrojtja e Thaçit thirri për të dhënë dëshmi këtë javë, profesore Helen Freizër, dëshmitare eksperte në fushën e transkriptimit forenzik. Prof. Freizër dha dëshmi të hënën dhe të martën, gjatë së cilës iu bënë pyetje edhe nga Prokuroria dhe Gjykatësi i Vetëm. Gjykatësi gjithashtu u kujtoi palëve afatet e caktuara në vendimin e tij të mëparshëm, përfshirë afatin e caktuar për Mbrojtjen për dorëzimin e njoftimeve lidhur me mbylljen e paraqitjes së provave të veta, si dhe afatin për Prokurorinë për të njoftuar nëse synonte të paraqiste kundërprova, përkatësisht më 14 dhe 15 maj.

Së fundi, në çështjen e Pjetër Shalës, Paneli i Gjykatës Supreme caktoi 18 majin si afat për Mbrojtjen e Shalës për dorëzimin e versionit të redaktuar publik të një kërkesë të paraqitur prej saj dhe caktoi afatet përkatëse për përgjigjen e Mbrojtjes së Viktimave dhe kundërpërgjigjen e Mbrojtjes. Më 11 maj, Administratorja caktoi Sajmon Loz si Mbrojtës të Viktimave për t'iu përgjigjur parashtrimeve të Mbrojtjes së Shalës.

Z. Shala u dënua për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme dhe Trupi Gjyqësor e urdhëroi të paguante shumë prej 208.000 eurosh si kompensim për dëmin fizik, mendor dhe material që pësuan viktimat pjesëmarrëse në proces. Paneli i Apelit rrëzoi apelin e z. Shala kundër urdhrin për zhdëmtim më 29 janar 2026 dhe aktualisht ai ka paraqitur kërkesë kundër këtij vendimi të Paneli i Gjykatës Supreme.

